

## HYRJJE

Ndërsa komunitetet fillojnë të rimëkëmben nga efektet shkatërrimtare të Sandy-t, është e rëndësishme të mos harrohen mësimet e nxjerra, të merren masa lehtësuese për të siguruar që ndërtimet të bëhen më të forta, më të sigurta dhe më pak të çënueshme nga përmbytjet në të ardhmen.

Përpara uraganit Sandy, Agjencia Federale e Menaxhimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA), e ngarkuar me detyrën e administrimit të programit kombëtar të sigurimit nga përmbytjet (National Flood Insurance Program) (NFIP), po studionte zonat e vijës bregdetare të Nju Xhërsit dhe Nju Jorkut për të përditësuar hartat e klasifikimit të sigurimit nga përmbytjet (Flood Insurance Rate Maps) (FIRMs). Këto harta të përditësuara ishte parashikuar tu dorëzoheshin zyrtarëve shtetërorë dhe lokalë nga mesi i vitit 2013. Meqenëse hartat ekzistuese (FIRMs) për këto zona ishin hartuar më tepër se 25 vjet më parë, dhe FIRMs e përditësuara ende nuk janë finalizuar, FEMA vendosi se ka rëndësi jetësore të sigurohen nivelet bazë të alarmeve në rast përmbytjesh (Advisory Base Flood Elevations) (ABFEs) për të mbështetur rindërtimin.

ABFEs hartohen duke përdorur shkencën dhe inxhinierinë e shëndoshë të mbështetur nga të dhënat më të freskëta dhe metodologjitë e përmirësuara studimore të krahasuara me FIRMs ekzistuese. Është e mundur që ABFEs të reflektojnë nivele më të larta alarmi se sa FIRMs rregullatorë aktuale. Pronarët e shtëpive dhe bizneseve duhet të kontaktojnë zyrën lokale të ndërtimit për të kuptuar më mirë kërkesat për përdorimin e ABFEs gjatë rindërtimit.

ABFEs do të vihen në dispozicionin e të gjitha konteve të mëposhtme ose një pjese të tyre:

- Konteja e Nju Xhërsit: Atlantic, Bergen, Burlington, Cape May, Essex, Hudson, Middlesex, Monmouth, Ocean, dhe Union.
- Konteja e Nju Jorkut: Bronx, Kings, New York, Richmond, Queens, dhe Westchester.

Për të parë shtrirjen e plotë të vendeve ku do të lëshohen ABFEs, lutemi vizitoni:  
[www.Region2Coastal.com](http://www.Region2Coastal.com).

Për të shpjeguar më mirë implikimet e ABFEs, FEMA ka përgatitur këtë dokument që përmban pyetjet e bëra shpesh.

## **PYETJE TË PËRGJITHSHME RRETH NIVELEVE BAZË TË ALARMEVE NË RAST PËRMBYTJESH (ABFE)**

### **1.1 ÇFARË JANË NIVELET BAZË TË ALARMEVE NË RAST PËRMBYTJESH (ABFEs)?**

ABFEs kanë natyrë paralajmëruese dhe më saktësisht, reflektojnë nivelet e vërteta të shansit vjetor të rrezikut prej 1% nga përmbytjet në një zonë të caktuar. Pas ngjarjeve nga stuhitë e mëdha, si uragani Sandy, FEMA bën vlerësimin për të përcaktuar nëse shansi vjetor për përmbytje prej 1%, që tregohet nga FIRMs efektive reflekton si duhet rrezikun aktual të përmbytjeve. Në disa raste, për shkak të analizës dhe shkencës të përdorur për të hartuar FIRMs efektive, FEMA përcakton se ka nevojë të hartohen ABFEs. ABFEs u sigurohen komuniteteve si një mjet për t'i mbështetur ata në rimëkëmbjen e tyre në mënyrë që t'i bëjnë ata më të qëndrueshëm përballë stuhive në të ardhmen.

### **1.2 A KA LËSHUAR FEMA ABFEs NË TË KALUARËN? NË RAST SE PO, KU DHE A ISHIN TË SUKSESSHME?**

Po, FEMA hartoi ABFEs pa uraganit Katrina më 2005. Shumë komunitete adoptuan ABFEs në Luiziana dhe Misisipi, gjë që çoi pronarët e shtëpive dhe bizneseve të ndërtonin në zona më të larta dhe më të sigurta. Kjo do të thoshte edhe premiume më të ulëta për sigurimin nga përmbytjet bazuar në FIRMs-et e rifreskuara disa vite më vonë.

### **1.3 PËR CILAT KONTE TË NJU XHËRSIT DHE NJU JORKUT DO TË LËSHOHEN ABFEs ?**

ABFEs do të lëshohen për të gjitha apo për një pjesë të konteëve të mëposhtme në Nju Xhërsi dhe Nju Jork:

Kontetë e Nju Xhërsit: Atlantic, Bergen, Burlington, Cape May, Essex, Hudson, Middlesex, Monmouth, Ocean, dhe Union.

Kontetë e Nju Jorkut: Bronx, Kings, New York, Richmond, Queens, dhe Westchester.

Ky informacion do të vihet në dispozicion në dhjetor 2012. Për të parë shtrirjen e plotë të vendeve ku do të lëshohen ABFEs, lutemi vizitoni: [www.Region2Coastal.com](http://www.Region2Coastal.com).

### **1.4 SI DO TË HARTOHEN ABFEs PËR KONTETË E GODITURA NGA URAGANI SANDY ?**

FEMA do të përdorë metodologjitë më të fundit të studimeve bregdetare si dhe të dhënat topografike në zonat bregdetare të Nju Xhërsit dhe Nju Jorkut. Këto ABFEs do të mbështeten edhe mbi punën që po kryhet dhe do të reflektojnë një analizë të përditësuar të bregdetit.

## **1.5 ÇFARË INFORMACIONI DO TË PËRFSHIJNË ABFEs QË DO TË VIHEN NË DISPOZICION TË TË INTERESUARVE?**

ABFEs do të përfshijnë nivelet bazë të alarmeve në rast përmbytjesh të zonave bregdetare dhe hartat shoqëruese paralajmëruese. Ky informacion do të përfshijë sa më poshtë:

**Shtresat me të dhëna paralajmëruese sipas kontesë:** shtresat gjeo-hapësinore që përshkruajnë ABFEs dhe zonat e përditësuara të përmbytjeve (përfshi por jo kufizuar vetëm në Zonën A të Rrezikut Paralajmërues për Përmbytje, Zonën V të Rrezikut Paralajmërues për Përmbytje, Limitin e Veprimit Valor të Kufizuar (LiMWA), dhe Zonën e Veprimit Valor të Moderuar, që njihet gjithashtu si Zona Bregdetare A), të dhënat e mbledhura për nivelet e larta të ujit që reflektojnë impaktin e Sandy-t si dhe Zonat amerikane të barrierave bregdetare për peshkimin dhe kafshët e egra (U.S. Fish and Wildlife Coastal Barriers Zones) që komunitetet mund t'i fusin në Sistemet e Informacioneve Gjeografike (GIS) për t'i ndihmuar për marrjen e vendimeve në lidhje me zonimin, ndërtimin dhe rihvillimin.

**Hartat paralajmëruese sipas kontesë:** Harta me panele që përshkruajnë shtresat gjeo-hapësinore të referuara më sipër. Këto harta paralajmëruese do të reflektojnë nivele më të larta të përmbytjeve dhe në disa raste, zona më të gjëra bregdetare të përmbytjeve.

**Raporti i metodologjisë për ABFEs:** një raport që përmbledh metodologjitë, supozimet dhe burimet e të dhënave të përdorura në hartimin e shtresave me të dhënat paralajmëruese dhe hartave.

## **1.6 KUR DO TË VIHEN NË DISPOZICION ABFEs?**

Po punohet për të përgatitur ABFEs-të. FEMA parashikon lëshimin e ABFEs-ve në dhjetor 2012.

## **1.7 KUSH DUHET T'I PËRDORË ABFEs?**

Komunitetet duhet t'i përdorin ABFEs për çdo aktivitet të FEMA-s për rimëkëmbjen apo lehtësimin e pasojave (p.sh., ndihma publike, grantet për uljen e rrezikut). Përveç kësaj, FEMA rekomandon që zyrtarët e komuniteteve përfshi zyrtarët e menaxhimit të ndërtesave dhe të ultësirave të kërcënuara nga përmbytjet, pronarët e shtëpive, pronarët e bizneseve, arkitektët, ndërtuesit dhe inxhinierët duhet ta përdorin këtë informacion sepse ABFEs do të përshkruajnë më me saktësi rreziqet aktuale nga përmbytjet.

## **1.8 SI MUND TË GJENDEN ABFEs ?**

ABFEs do t'i gjeni në adresën e internetit të rajonit bregdetar II të FEMA-s (Region II Coastal Website) në [www.Region2Coastal.com](http://www.Region2Coastal.com). Ky uebsit përmban gjithashtu udhëzimet për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të informuara në lidhje me rindërtimin e komuniteteve.

## **1.9 SI DO TË FAKTORIZOHEN NDIKIMET E URAGANIT SANDY NË INFORMACIONIN PARALAJMËRUES?**

Madhësia specifike dhe rrugëtimi i uraganit Sandy nuk do të faktorizohet në analizën e përditësuar të bregdetit për ABFEs. FEMA përdor probabilitetet statistikore të stuhive historike si pjesë të analizës së përditësuar të bregdetit që nuk përfshin ngjarje individuale nga ndodhitë e kaluara. Stuhitë historike që kanë rrugëtime dhe madhësi të njëjta me uraganin Sandy janë të llogaritura në analizën statistikore dhe përfshirja e uraganit Sandy nuk do të ndikonte në rezultatet e ABFEs ose në përshkrimin e zonave paralajmëruese të përmbytjeve. FEMA do të sigurojë të dhënat e niveleve të ujit të vëzhguara nga uragani Sandy si të dhëna pika në hartat paralajmëruese të mbledhura nga Survejimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara (United States Geological Survey). Gjithashtu, një sërë nivelesh të përmbytjeve që u arritën si rezultat i uraganit Sandy do të jepen në seksionin informativ të çdo paneli të hartës paralajmëruese.

## **1.10 PSE DISA ABFEs JANË MË TË LARTA SE NIVELET E TREGUARA NË FIRMS EFEKTIVE?**

Rreziku nga përmbytjet mund të ndryshojë me kalimin e kohës për shkak të ndryshimeve klimaterike, të popullsisë, zhvillimit në komunitet dhe rreth tij, si dhe faktorëve të tjerë. Nivelet paralajmëruese të përmbytjeve bazë (BFEs) të treguara në FIRMS efektive aktuale bazohen në studimet që u kryen më tepër se 25 vjet më parë. ABFEs bazohen në informacionin nga studimet e hartave të rrezikut të përmbytjeve që po hartoheshin përpara uraganit Sandy, dhe përfshijnë 25 vjet të tjera të të dhënave të përmbytjeve dhe të të dhënave topografike të përditësuara. Si rezultat ABFEs do të reflektojnë nivele më të larta se sa BFEs të treguara në FIRMS efektive aktuale.

## **1.11 PSE ABFEs TREGOJNË DISA NIVELE MË TË ULËTA SE SA NIVELET E PËRMBYTJEVE TË URAGANIT SANDY?**

ABFEs bazohen në shansin vjetor 1% të përmbytjeve. Në disa zona, ABFEs mund të tregojnë nivele më të ulëta se uragani Sandy sepse Sandy ishte një ngjarje më ekstreme se sa parashikonte shansi vjetor 1% i përmbytjeve në disa zona. Nivelet e përmbytjeve me shans vjetor 1% janë në standardin NFIP për menaxhimin e ultësirave të rrezikuara nga përmbytjet. Është e rëndësishme të vihet re se ndërtesat e ndërtuara me këtë standard janë ende të dobëta përpara efekteve të ngjarjeve më të mëdha të tilla si uragani Sandy.

## **2. PYETJE RRETH MENAXHIMIT TË ULTËSIRAVE TË RREZIKUARA NGA PËRMBYTJET NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E ABFEs DHE HARTAVE PARALAJMËRUESE PËR RINDËRTIMIN**

### **2.1 A DUHET QË KOMUNITETI IM TË MIRATOJË HARTA PARALAJMËRUESE DHE ABFEs PËR RINDËRTIM ME QËLLIM QË TË KETË TË DREJTËN PËR TË MARRË PJESË NË NFIP?**

Jo. Një komunitet që merr pjesë në NFIP nuk ka nevojë të përdorë hartat paralajmëruese dhe ABFEs. Hartat paralajmëruese dhe ABFEs u sigurojnë komuniteteve vlerësimin e niveleve minimale të përmytjeve dhe zonave me rrezik përmytjeje të cilat mund t'i përdorin gjatë rindërtimit për të minimizuar dëmet në të ardhmen.

### **2.2 CILAT JANË PËRFITIMET PËR KOMUNITETIN TIM NGA PËRDORIMI APO MIRATIMI I ABFEs DHE HARTAVE PARALAJMËRUESE?**

Përdorimi i ABFEs për rindërtimin mund të ulë ndjeshmërinë e strukturave ndaj përmytjeve dhe dëmeve nga përmytjet. Ndërtimet sipas ABFEs mund të ulin koston e sigurimit të përmytjeve, si dhe koston e rimëkëmbjes ndaj stuhive në të ardhmen dhe përmytjeve. Ndërsa kostoja fillestare e rindërtimit në bazë të ABFEs mund të jetë pak më e lartë, komunitetet dhe pronarët e shtëpive dhe bizneseve do të kursejnë para në një shtrirje kohore më të madhe duke i bërë strukturat më rezistente ndaj dëmeve të kushtueshme nga përmytjet. FEMA do të sigurojë ndihmën teknike për komunitetet në adoptimin dhe implementimin e ABFEs dhe hartave paralajmëruese.

### **2.3 NË RAST SE KOMUNITETI IM VENDOS TË ZBATOJË ABFEs, A ËSHTË E NEVOJSHME TË KORRIGJOJË RREGULLOREN E MENAXHIMIT TË ULTËSIRAVE TË RREZIKUARA NGA PËRMBYTJET DHE/OSE KODET NDËRKOMBËTARE TË NDËRTIMIT ® PËR TË REFLEKTUAR ABFEs?**

Përgjithësisht po. Komuniteti duhet të miratojë ABFEs dhe administratori juaj i ultësirave të rrezikuara nga përmytjet do të duhet të zbatojë rregullat e amenduara.

### **2.4 NË ZONAT KU NIVELET E IMPAKTEVE TË URAGANIT SANDY I KAPËRCEJNË ABFEs, A DUHET QË KOMUNITETET TË NDËRTOJNË NË ZONA MË TË LARTA?**

Po. Është praktikë e mirë për të ndërtuar më lart. Disa opsione pse komunitetet dhe pronarët e ndërtesave duhet të sigurojnë mbrojtje shtesë përfshijnë:

- Miratimi apo përdorimi i distancës nga uji përveç ABFEs.
- Përdorimi i pirgjeve apo themeleve në formë kolone për të ngritur ndërtesat e banimit kërkohet në zonat V. Përveç kësaj, kjo mund të kërkohet edhe në zonat ekzistuese AE.

## **2.5 A MUND TË MIRATOJË KOMUNITETI KËRKESËN PËR DISTANCËN NGA UJI PËRVEÇ NIVELEVE BAZË TË PËRMBYTJEVE (BFES) SI NJË ALTERNATIVË E MIRATIMIT TË ABFEs?**

Po. Megjithatë, komunitetet duhet të tregohen të kujdesshme në miratimin e BFES dhe distancën nga uji në rast se ato janë më të ulëta se ABFEs. Strukturat e ndërtuara sipas BFE plus distancën nga uji do të jenë me të ndjeshme ndaj dëmeve të përmbytjeve se sa strukturat e ndërtuara sipas ABFE ose më lart.

Përveç kësaj, pronarët e shtëpive dhe komunitetet duhet të jenë të ndërgjegjshëm se norma e sigurimit do të preket nga ligji për reformën e sigurimit nga përmbytjet Biggert-Waters (Flood Insurance Reform Act) e vitit 2012, i cili mandaton eliminimin e subvencionimeve dhe uljen e premieeve të sigurimit nga përmbytjet dhe rritjen e normave për të reflektuar rrezikun aktual. Në rast se FIRM-at efektive kanë BFES më të larta, banorët ndërtesat e të cilëve janë nën nivelin e ri mund të paguajnë premie esencialisht më të larta për sigurimin nga përmbytjet.

## **2.6 KUR FEMA SIGURON FIRMS-at FINALE QË ZËVENDËSOJNË ABFEs-të, A DUHET QË KOMUNITETI IM TË MIRATOJË FIS-at DHE FIRMS-at e RISHIKUAR?**

Po. Sa herë që FEMA rishikon FIRMS-at efektive, komuniteti duhet të miratojë ose korrigjojë rregullat e menaxhimit të ultësirave të rrezikuara nga përmbytjet për të inkorporuar të dhënat e reja dhe për të përballuar çdo kërkesë tjetër të menaxhimit të ultësirave të rrezikuara nga përmbytjet. Informacion shtesë në lidhje me miratimin e FIRMS mund t'i gjeni në broshurën e FEMA, *Miratimi i hartave të normave të sigurimit nga përmbytjet nga komunitetet pjesëmarrëse (Adoption of Flood Insurance Rate Maps by Participating Communities)* (FEMA 495 – Shtator 2005).

# **3. IMPLIKIMET E SIGURIMIT NGA PËRMBYTJET**

## **3.1 NË RAST SE KOMUNITETET MIRATOJNË DHE PËRDORIN ABFEs, SI DO TË NDIKOJË KJO NË PREMIUMET DHE POLICAT E SIGURIMIT NGA PËRMBYTJET TË PRONARËVE?**

Miratimi i standardeve të bazuara në ABFEs nuk do të ndryshojë zonat ose nivelet që janë aktualisht në fuqi, ndërsa premiumet do të vazhdojnë të caktohen bazuar në hartën që është aktualisht në fuqi dhe katit më të ulët të ndërtesës. Policat e sigurimit nga përmbytjet përcaktohen sipas zonave dhe niveleve të përmbytjeve në FIRM-at efektive aktuale. Normat e

premiemeve të sigurimit nga përmbytjet mund të ndikohen nga ligji për reformën e sigurimit nga përmbytjet (Biggert-Waters Flood Insurance Reform Act) i vitit 2012 (shih Seksionin 3.2).

### **3.2 ÇFARË DO TË NDODHË PËR NORMAT E RINOVUARA PËR POLICAT EKZISTUESE TË SIGURIMIT NGA PËRMBYTJET NË RAST SE FIRMS-at RISHIKOHEN NË TË ARDHMEN PËR TË REFLEKTUAR NIVELE TË REJA MË TË LARTA?**

Me përditësimin e hartave të përmbytjeve, zonat në rrezik përmbytjeje dhe premiumet mund të ndryshojnë për të reflektuar rrezikun e ri nga përmbytjet. Normat do të ndikohen gjithashtu edhe nga ligji i reformës të sigurimit nga përmbytjet (Biggert-Waters Flood Insurance Reform Act) i vitit 2012, i cili mandaton eliminimin e subvencioneve dhe uljeve të premieeve të sigurimit nga përmbytjet dhe rritjen e normave për të reflektuar rrezikun aktual. Në rast se FIRM-at efektive ka BFEs më të larta, banorët ndërtesat e të cilëve janë nën nivelin e ri mund të paguajnë premie esencialisht më të larta për sigurimin nga përmbytjet.

### **3.3 A DO TË KETË PËRFTIME PËR SHKAK TË RITJES SË KOSTOS NGA PAJTUESHMËRIA (ICC) PËR TË NDIHMUAR NË MBULIMIN E KOSTOVE PËR NGRITJEN E NDËRTESES?**

Mbulimi me ICC është një mbulim standard në shumicën e policave NFIP. Mbulimi siguron deri në \$30.000 në ndihmë të pronarëve të shtëpive për të pakësuar rrezikun nga dëmet nga përmbytjet në të ardhmen duke ndërtuar në zona më të larta, duke marrë masa mbrojtëse kundër përmbytjeve (për strukturat jo rezidenciale), duke prishur apo rilokalizuar ndërtesën apo shtëpinë në bazë të kërkesave të rregullorëve lokalë për ndërtim. Ky mbulim i shtohet mbulimit të ndërtesave për riparimin e dëmtimeve aktuale fizike nga përmbytja. Megjithatë, pagesat totale të kërkesave nuk mund të kapërcejnë limitet staturore. Prandaj, sasia maksimale që merret si për ICC dhe dëmin fizik nga përmbytja për një shtëpi banimi për një familje është \$250.000.

### **3.4 NË RAST SE NJË SHTËPI NDËRTOHET NË PËRPTHJE ME FIRM-at EFEKTIVE AKTUALE DHE DËMTOHET RËNDË A DO TA MBULOJË ICC-ja KOSTON PËR TË NGRITUR STRUKTURËN NË BFE OSE ABFE?**

Po, në çfarëdo niveli që ka miratuar komuniteti dhe që zbatohet në të gjithë komunitetin.

### **3.5 NË RAST SE SHTËPISË I SHTOHET NJË KAT I DYTË DHE KATI I PARË KTHEHET NË PARKING, MAGAZINË OSE AKSES HYRËS, A PËRFITON KJO STRUKTURË TEKNIKE NGA ICC-ja?**

Jo. ICC-ja do të mbulojë vetëm strukturën që plotëson përkufizimin e sigurimit të një strukture të ngritur.

### **3.6 NË RAST SE PRONARI SHKATËRRON SHTËPINË, A I LIND ATIJ E DREJTA PËR TË PËRFITUAR DERI NË \$30.000 PËR TË NGRITUR SHTËPI TË RE NË NIVEL TJETËR?**

Po, në rast se niveli i ngritjes është në përputhje me BFE, BFE plus distancën nga uji, ose ABFE si kërkohet nga komuniteti dhe struktura është në një ultësi të rrezikuar të hedhur në hartë në FIRM efektive aktuale. ICC-ja do të mbulojë deri në \$30.000 për çdo kombinim të aktiviteteve të mëposhtme:

- Niveli (ngritja)
- Sigurimi nga përmbytja (vetëm ndërtesat jo rezidenciale)
- Zhvendosja
- Shkatërimi

### **3.7 NË RAST SE NJË KOMUNITET SHKATËRRON SHTËPITË E DËMTUARA, POR NUK SHKATËRRON PLLAKAT E BAZËS, A DO TA MBULOJË ICC-JA SHKATËRRIMIN E TYRE?**

Po. ICC-ja do të mbulojë shkatërrimin e pllakave, por ICC-ja nuk do të mbulojë koston e shkatërrimit që është paguar tashmë nga një burim tjetër financiar.

### **3.8 A MUND TË NGRIHET NJË STRUKTURË BANIMI PËR \$30.000?**

Varet. Ka shumë faktorë që ndikojnë në koston në lidhje me ngritjen e shtëpive. Faktorët e tillë si madhësia e shtëpisë, tipi i ndërtimit, përfshi tipin e themelit, kushtet dhe forma e shtëpisë, gjendja e pllakës, ngjitja e shërbimeve komunale dhe çka është më e rëndësishme, duhet të konsiderohet lartësia e ngritjes.

### **3.9 ÇFARË BURIMESH TË TJERA VIHEN NË DISPOZICION NGA MBULIMI I ICC-SË DHE NGRITJA E STRUKTURËS?**

Burimet e ICC-së:

- Mbulimi i rritjes së koston të pajtueshmërisë të programit kombëtar për sigurimin nga përmbytjet (National Flood Insurance Program Increased Cost of Compliance Coverage), Udhëzues për zyrtarët e shtetit dhe ata lokalë, FEMA 301/Shtator 2003;  
<http://www.fema.gov/library/viewRecord.do?fromSearch=fromsearch&id=1532>
- Rritja e koston së pajtueshmërisë, F-663/Gusht 2002  
<http://www.fema.gov/library/viewRecord.do?fromSearch=fromsearch&id=3009>
- Informacioni rreth rritjes së koston së pajtueshmërisë (ICC) mund të gjendet në:  
<http://www.fema.gov/national-flood-insurance-program-2/increased-cost-compliance-coverage>



Botimet e FEMA-s:

- Parimet dhe praktikat e pajisjes së strukturave rezidenciale të rrezikuara nga përmbytjet (Principles and Practices of Retrofitting Floodprone Residential Structures), FEMA 259/Janar 1999 ;  
<http://www.fema.gov/library/viewRecord.do?fromSearch=fromsearch&id=1645>
- Udhëzuesi i pronarëve për pajisjen e shtëpive, gjashtë mënyra për të mbrojtur shtëpinë nga përmbytjet (Homeowner's Guide to Retrofitting, Six Ways to Protect Your House from Flooding), FEMA 312/Qershor 1998;  
<http://www.fema.gov/library/viewRecord.do?fromSearch=fromsearch&id=1420>

Botimet USACE për mbrojtjen nga përmbytjet:

- (Ngritja ose lëvizja e pllakës në shtëpitë e pajisura me pllakë (Raising and Moving a Slab-on-Grade House With Slab), 1990
- (Mbrojtja nga përmbytjet - si të vlerësoni opsionet tuaja (Flood Proofing - How to Evaluate Your Options), 1993
- (Një histori e suksesshme e mbrojtjes nga përmbytjet në Drai Krik të Gudletsvill, Tenesi (Flood Proofing Success Story Along Dry Creek at Goodlettsville, Tennessee), 1993

Këto dhe botime të tjera mund t'i gjeni në uebsitin e mëposhtëm:

<http://www.usace.army.mil/Missions/CivilWorks/ProjectPlanning/nfpc.aspx>

## **4. SISTEMI I KLASIFIKIMIT TË KOMUNITETIT**

### **4.1 A MUND TË MARRË KREDITE KOMUNITETI IM SIPAS SISTEMIT NFIP TË KALSIFIKIMIT TË KOMUNITETIT (NFIP COMMUNITY RATING SYSTEM) (CRS) PËR APROVIMIN E ABFEs OSE DISTANCËS NGA UJI?**

Po. Disa komunitete të bregdetit të Nju Xhërsit dhe Nju Jorkut marrin pjesë në CRS të NFIP. Të siguruarit në këto komunitete marrin zbritje për premiumet e sigurimit nga përmbytjet sepse komunitetet e tyre implementojnë programet e menaxhimit të ultësirave të rrezikuara nga përmbytjet që kapërcejnë kërkesat minimale të NFIP-it. Komunitetet mund të marrin kredite CRS për miratimin dhe zbatimin e ABFEs ose për miratimin dhe zbatimin e kërkesave për distancën nga uji. Kreditet për miratimin e ABFEs hyjnë në fuqi me hyrjen në fuqi të FIRM-ave të rishqyrtuara.

Informacion shtesë rreth CRS-së mund të gjeni në:

<http://www.fema.gov/national-flood-insurance-program/community-rating-system>

## **5. APLIKIMI PËR ABFEs NË PROGRAMET E FEMA PËR GRANTE DHE NDIHMA PËR FATKEQËSITË**

### **5.1 A DO TË PËRDORË FEMA ABFEs PËR PROJEKTET E FEMA-S PËR GRANTET PËR RIMËKËMBJEN DHE LEHTËSIMIN E PASOJAVE?**

Po. Aktivitetet dhe programet e FEMA-s për rimëkëmbjen dhe lehtësimin e pasojave duhet të përdorin të dhënat më të mira të disponueshme për rrezikun nga përmbytjet përpara se t'i drejtohen fondeve federale.

### **5.2 PSE DUHET FEMA TË PËRDORË ABFEs PËR PROGRAMET E FEMA-S PËR GRANTE DHE NDIHMË PËR FATKEQËSITË?**

FEMA vepron për të ulur rreziqet nga humbjet nga përmbytjet, duke minimizuar impaktet e përmbytjeve mbi sigurinë e njerëzve, shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe restaurimin dhe ruajtjen e vlerave përfituese që arrihen nëpërmjet menaxhimit të ultësirave të rrezikuara nga përmbytjet në zbatimin e programeve tona. Grantet e FEMA-s për ndërtimet, riparimet, rehabilitimin, dhe/ose përmirësimin në ultësirat e rrezikuara nga përmbytjet i nënshtrohen Urdhrit Ekzekutiv (Executive Order) 11988, i kodifikuar në 44 CFR Pjesa 9. FEMA kërkohet të ndjekë një proces prej tetë shkallësh për marrjen e vendimit për çdo veprim me potencial që ndikon në ultësirat e rrezikuara dhe duhet të angazhojë mendimin e publikut gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes. FEMA siguron investime të rëndësishme për të ndihmuar komunitetet në rimëkëmbje nga goditja e uraganit Sandy. Përgjegjësia e FEMA-s është të sigurojë që investimet të jenë të zgjuara, të shëndosha dhe bazuar në informacionin shkencor më të mirë të disponueshëm. Kjo do të rrisë gjithashtu qëndresën e komunitetit ndaj rimëkëmbjes, duke dhënë vlerësimin e objekteve kritike dhe projekteve të tjera të FEMA-s të restaurimit të infrastrukturës dhe do të ndihmojë në udhëzimet për vendimet në lidhje me rimëkëmbjen dhe zbutjen e rrezikut në zonat e goditura për të pakësuar dëmet në të ardhmen.

### **5.3 SI DO T'I PËRDORË FEMA ABFEs-të NË PROGRAMET E ZBUTJES DHE RIMËKËMBJES?**

FEMA do të përdorë ABFEs-të për të përcaktuar kufijtë e zonave të përmbytjes dhe nivelet minimale të përmbytjes që kërkohen për standardet e projektimit dhe performancës. Këtu përfshihet përdorimi i ABFEs-ve për të përcaktuar në rast se banimet e përkohshme janë vendosur në ultësirat e rrezikuara nga përmbytjet. Kjo aplikohet në ngritjen e vendeve të përkohshme të banimit (THUs) si dhe ngritjen e qendrave të banesave në grup dhe lloje jo tradicionale banesash të përkohshme.

**5.4 NË RAST SE RREGULLORET E MENAXHIMIT TË ULTËSIRAVE TË RREZIKUARA JANË MË TË FORTA SE ABFEs-të E FEMA-S, CILIN STANDARD DO TË PËRDORË FEMA PËR VENDIMET PËR NDIHMË DHE GRANTE PËR FATKEQËSITË?**

Aktivitetet dhe projektet e financuara me grantet e FEMA-s duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat, ligjet dhe rregulloret federale, shtetërore dhe lokale. Në rast se kodet dhe standardet lokale janë më strikte se ABFE-të, projektet duhet të hartohen me standardin më të lartë.

**5.5 ÇFARË NDODH NË RAST SE TË DHËNAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME NDRYSHOJNË?**

Duhet të pranohet që të dhënat më të mira në dispozicion mund të ndryshojnë gjatë procesit të rimëkëmbjes. Për të qenë në përputhje me rregullat e FEMA-s (44 CFR 9,11(d)(6), asnjë projekt nuk duhet të ndërtohet sipas një standardi të menaxhimit të ultësirave të rrezikuara që nuk përputhet me NFIP-në ose rregulloret më pak shtrënguese të komunitetit për menaxhimin e ultësirave të rrezikuara. Ky informacion duhet të merret në konsideratë kur merren vendime për rimëkëmbjen.